



**HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A.**  
**BORDI I DREJTORËVE**

Nr. I/14

Datë: 30.01.2026

Bazuar në Nenin 34 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Nenin 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087, në bazë të Nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, si dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 10/273, datë 31.10.2025 për përcaktimin e pagës minimale, Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A. në Mbledhjen Nr. 31, të mbajtur më 30.01.2026 njëzëri nxori këtë:

**VENDIM**

- I. Për plotësim-ndryshime të Aneksit 1 të Rregullores për Paga dhe Kompensime Tjera të HK-Trainkos Sh.A Nr. I/120 të datës 30.09.2025.
- II. Në kuadër të Kategorizimit dhe Niveleve të Pagave të stafit të Ndërmarrjes, niveli i pagës për Kategorinë e VI-të, kalon nga shuma 380€ – 520€, në shumën 425€ – 520€.
- III. Obligohet Menaxhmenti të bëjë përgatitjet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, i cili do të reflektojë edhe në pagat e punëtorëve për muajin janar 2026.
- IV. Rritja e niveleve të pagës për Kategorinë e VI-të, do të reflektohet edhe në Aneksin 1 të Rregullores për Paga dhe Kompensime të Tjera të HK-Trainkos Sh.A., Nr. I/131, datë 29.08.2024, i cili do t'i bashkëngjitet këtij vendimi si pjesë përbërëse.
- V. Zbatimi i këtij vendimi fillon nga data 30.01.2026 dhe mbetet në fuqi deri në një vendim të ri të Bordit të Drejtorëve.

**Arsyetim**

Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 10/273, datë 31.10.2025 për përcaktimin e pagës minimale, si dhe në propozimin e Menaxhmentit për zbatimin e tij, Bordi i Drejtorëve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



  
**Jetmir NUKA – Kryesues**

**Iu dërgohet:**

- NJPMNP
- Kryeshefit Ekzekutiv
- Departamentit të Administratës
- Arkivit